

TIRANA

2023



HISTORIA, TRADITA E NATYRA
E KRYEQYTETIT TË SHQIPTARËVE

TIRANA

HISTORIA, TRADITA E NATYRA E KRYEQYTETIT TË SHQIPTARËVE 2023



Qendra për
Administrim Social
Ekonomik Territorial

“Ky botim është realizuar në kuadër të projektit “TIRANA : Historia, Tradita & Natyra e Kryeqytetit të Shqiptarëve. -Guidë Rinore” me mbështetjen financiare të Bashkisë Tiranë.


Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Qendrës ASET dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i Bashkisë Tiranë.

Përmbajtja

POZICIONI GJEOGRAFIK DHE KLIMA	05
PREJARDHJA E EMRIT TIRANË	06
HISTORIKU I QYTETIT	07
PLANET URBANE TË QYTETIT	10
TIRANA GJATË LUFTRAVE BOTËRORE	12
TIRANA NË VITET 1944-1990	14
TIRANA PAS VITEVE 1990	18
ATRAKSIONE TË TIRANËS	20
TURIZMI RURAL	25
TURIZMI FETAR	31
ETNOGRAFI	37
KARTOLINA	48

Pozicioni gjeografik dhe klima

Tirana ndodhet në një lartësi mesatare 114 metër mbi nivelin e detit dhe shtrihet në skajin juglindor të fushës së Tiranës, ndërmjet malit të Dajtit në Lindje, kodrave të Kërrabës dhe të Saukut në Jug, kodrave të Vaqarrit dhe Yzberishit në Perëndim dhe kodrave të Kamzës në Veri. Kodrat që rrethojnë Tiranën. shkojnë deri në 250–300 m lartësi. Tirana bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare fushore që përfshin gjithë Ultësirën Bregdetare dhe që karakterizohet nga dimri relativisht i butë e i lagësht dhe nga vera e nxehtë dhe e thatë. Temperatura mesatare vjetore në Tiranë është 15° C, mesatarja e janarit 6,7° C, mesatarja e korrikut 23,8° C, maksimumi absolut 41,5° C (13.07.1973), minimumi absolut -10,4° C (15.01.1968).



Prejardhja e emrit *Tiranë*



Disa historianë shohin tek emri i kalasë Tyrkanos, që e përmend kronisti bizantin i shek. VI, Prokopi i Cezaresë, emrin e Tiranës së sotme. Si emër vendi, në trajtën e sotme Tirana përmendet për të parën herë (si fshat apo si fushë nuk është e sigurt) në çerekun e fundit të shek. XIV. Në shek. XV emri i saj përmendet në tri trajta: Tirana e Vogël (Tyrrana Minor), si emër fushe ku shtrihet kryeqyteti i sotëm; Tirana e Madhe (Tyrrana Major), si emër fushe, vazhdim i saj nga ana veriperëndimore dhe në fund Tirana (Tyrranna) e pacilësuar, e cila supozohet të ketë qenë qendër banimi në Tiranën e Vogël. Në vitin 1583 Tirana del e shënuar në defterin osman si një fshat me 8 shtëpi nga të cilat 7 myslimane dhe një e krishterë.

Një tjetër variant është ai i prezantuar nga Teki Selenica në botimin e tij të vitit 1929 "Shqypnija e Ilustrueme". Sipas këtij botimi, emri Tiranë vjen nga fjala latinisht tyros e greqisht turos (djathë), çka nënkupton një zonë me bulmet. Mbështetësit e kësaj hipoteze e lidhin këtë gjë me faktin se ilirët si blegtorë të zotë ishin të njohur për prodhimin dhe tregtinë e djathit të deles. Ndoshta fusha e Tiranës u quajt kështu sepse aty prodhohej dhe shitej djathi i deles.

Versioni i tretë ka të bëjë më tepër me etimologjinë dhe mbështetet në hipotezën e transformimit të togfjalëshit vendas "të ranat", që nënkupton një fushë të formuar nga prurjet e ngurta të ujërave që rridhin në të. Me të njëjtën logjikë mendohet se ka ardhur edhe emri i lumit të Lanës, dmth. "të lana", pra mbetjet e ngurta që linte pas përroi/ lumi që kalon ende në mes të qytetit.

Gjithsesi, fakti që prejardhja e emrit të kryeqytetit nuk ka një shpjegim të plotë e bindës, nuk e bën atë një rast të veçantë. Ka edhe kryeqytete të njohura europiane, emri i të cilëve nuk është shpjeguar ende saktësisht.

Historiku i nje qyteti

Në vitin 1614, një sanxhakbej me emrin Sulejman Pashë Bargjini, ndërtoi në qendrën e sotme të kryeqytetit një xhami, një han, një hamam dhe një furrë, të cilat nuk ekzistojnë më sot. Përzgjedhja e këtij vendi nuk ishte pa qëllim, sepse në të kryqëzoheshin disa rrugë të rëndësishme tregtare të karvanëve.

Në vitin 1707 Tirana kishte 400 shtëpi dhe me kalimin e kohës u shndërrua në një nga qytetet më kryesore të Shqipërisë së Mesme. Ndërkohë, ende nën pushtetin e pasardhësve të themeluesit të saj, Tirana tërhoqi lakminë e feudalëve të viseve fqinje. Në luftën për zotërimin e saj u dalluan feudalët e Krujës - pinjollët e familjes Toptani. Ibrahim Pashë Bargjinolli dhe pasardhësit e tij e mbajtën, me disa ndërprerje, pushtetin mbi trevën deri në vitin 1818, kur Kapllan pashë Toptani e shtiu Tiranën përfundimisht në dorë.

Gjatë shek. XIX Tirana njohu njëfarë zhvillimi ekonomik, shoqëror, kulturor dhe artistik. Qyteti mori trajtën urbanistike që e ruajti deri në fund të Luftës së Parë Botërore. U ngritën ndërtesa me dritare. Vendin e xhamive të thjeshta e zunë xhamitë e reja të zbukuruar me shtylla të pajisu-





ra me kapitole dhe me afreske shumëgjyreshe me motive floreale dhe arabeska; prej tyre ruhet vetëm Xhamia e Haxhi Ethem Beut, e vitit 1821, me kullën e sahatit pranë saj. Pjesë karakteristike ishte kompleksi i Çarshisë (Pazari i Vjetër), që u prish gjatë ndërtimit të Pallatit të Kulturës. Rreth mesit të shek. XIX kazaja e Tiranës u shkëput administrativisht nga sanxhaku i Ohrit (vilajeti i Manastirit) dhe u lidh me atë të Durrësit, i cili bënte pjesë në vilajetin e Shkodrës. Në këtë kohë Tirana ishte ende

qytet i prapambetur. Kishte vetëm një medrese kuranore. Familjet me të ardhura të mira i dërgonin fëmijët për t'u arsimuar në qytete të zhvilluara të Perandorisë Osmane, madje dhe në disa qytete të Perëndimit.

Pas vitit 1908, me fitoren e revolucionit xhonturk, banorët e Tiranës kaluan nga lëvizja kulturore, në lëvizjen për autonominë e Shqipërisë. Më 1912 edhe qytetarët e Tiranës formuan çeta patriotike në kuadrin e





kryengritjes së përgjithshme kundërosmane. Tirana u përfaqësua me dy delegatë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, që shpalli Pavarësinë e Shqipërisë më 28 nëntor 1912. Por gjatë Luftës së Parë Ballkanike, Tirana u push-tua nga ushtritë serbe dy ditë para se të shpallej Pavarësia. Pas largimit të ushtrive serbe në prill 1913 dhe pas periudhës 6-mujore të qeverisjes së princ Vidit, Tirana u zhyt në anarkinë e krijuar nga kryengritja esadiste dhe ajo e Haxhi Qamilit, derisa kjo u shtyp nga ushtria serbe, të cilat në qershor 1915 ripushtuan Tiranën, për të dytën herë. Më pas, gjatë Luftës së Parë Botërore, në janar 1916, Tirana u pushtua nga ushtria austro-hungareze, kurse në fund të luftës nga ushtria italiane.

Organet e larta të shtetit shqiptar, që dolën më 1920 nga Kongresi i Lushnjës (shih) u vendosën më 11 shkurt 1920 në Tiranë, që u caktua përkohësisht kryeqytet i Shqipërisë, kurse përfundimisht Tirana u shpall si kryeqytet me statutin e Republikës Shqiptare në janar 1925. Pas 1920 filloi popullimi me banorë të ardhur nga krahina e qytete të tjera të vendit.


Më 1922 Tirana u shkëput si nënprefekturë nga prefektura e Durrësit dhe u bë prefekturë më vete. Më 1923 ajo kishte 12.453 banorë.

Planet rregulluese të qytetit

Stabiliteti i periudhës 14-vjeçare të qeverisjes së A. Zogut ndihmoi për zhvillimin e Tiranës. Qeveritë shqiptare të asokohe përshpejtuan punën për hartimin e një plani rregullues, çka përbënte risi për qytetin. Sikurse ndodh edhe sot, dilema ndërmjet “të vjetrës dhe të resës” ishte e pranishme edhe atëherë dhe shtrohej pyetja nëse duhej të ndërtohej një qytet i ri jashtë qytetit të vjetër apo duhej prekur edhe qyteti i vjetër. Sikurse ndodh gjithmonë, u arrit një kompromis.

Plani i parë rregullues i qytetit u përgatit në vitin 1923. Disa autorë mendojnë se ai u hartua nga Eshref Frashëri, ndërkohë që të tjerë mendojnë se plani është përgatitur nga austriakët. Gjithsesi ky ishte një plan që nuk gjeti zbatim dhe u pasua disa vite më vonë, në vitet 1925-1927 nga një tjetër plan, i cili financohej nga Shoqëria italiane për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë (SVEA) me një arkitekt italian, Armando Brasini. Brasini parashikonte ndërtimin e bulevardit kryesor në aksin Veri-Jug, sheshin qendror dhe një shesh tjetër në Veri, ku parashikohej të lireshin ndërtimet e traditës. Ndërtimet e reja do të ishin të stilit klasik dhe neoklasik të fundshekullit XIX. Ky plan nuk mund të zbatohej për shkak të kostove të larta të ndërtimeve por idetë e Brasinit do të gjenin vend në të gjithë planet e mëvonshme rregulluese të qytetit.

Plani i tretë rregullues i kryeqytetit u hartua në vitin 1928 nga arkitekti austriak Köhler në vitin 1928. E veçanta e tij ishte se në të përfshihej gjithë qyteti. Ndonëse ai ruajti bulevardin e propozuar nga Brasini dhe përfshiu në të dy nga ndërtesat më të rëndësishme të identitetit të qytetit Kullën e Sahatit dhe Xhaminë e Et'hem Beut, ai nuk u miratua.



Një vit më vonë, në vitin 1929 u hartuan plani i katër rregullues i Tiranës, i cili edhe do të miratohej. Autor i tij ishte arkitekti italian Florestano de Fausto. Së bashku me bulevardin kryesor u projektuan edhe kompleksi i ministrive dhe bashkia e qytetit. Po ashtu, plani



Shqipërisë dhe u ngrit radiostacioni dhe filloi nga puna Radio Tirana me emisione të kufizuara. Filloi të marrë formë e të rritet gjithnjë e më shumë Tirana e Re, pjesa e re e qytetit me vilat e funksionarëve e me rrugë të drejta, ndërsa Tirana e Vjetër ishte pjesa ku zhvillohej jeta ekonomike dhe banonte shumica dërmuese e qytetarëve, me shtëpi të ulëta, me rrugë e rrugica të ngushta. Ato ndaheshin në mes nga përroi i Lanës. Në të dy pjesët nuk kishte ujësjellës dhe as kanalizime për ujërat e zeza. Qytetarët furnizoheshin me ujë nga pusët. Në Tiranën e vjetër mbizotëronin shtëpitë me qerpiç. Filloi gjallërimi i jetës kulturore e artistike. Tirana kishte tri shkolla të mesme (dy për



parashikoi ehe ruajtjen e objekteve të rëndësishme të identitetit kryeqytetas, si kulla e sahatit, xhamitë, Pazarin e Vjetër etj. Në vitin 1931 u ngrit ansambli i ndërtesave të ministrive në sheshin "Skënderbej"; më 1938 përfundoi ndërtimi i Bankës Kombëtare të

djem e një për vajza). U ndërtuan tri kinema. Filluan shfaqjet teatrale, programet artistike dhe organizimi i klubeve sportive. Gjatë viteve 1930 popullsia e kryeqytetit u rrit nga 31 mijë banorë në vitin 1930 në 38 mijë banorë në vitin 1938.

Tirana gjatë luftës së II-të botërore

Stabiliteti i periudhës 14-vjeçare të qeverisjes së A. Zogut ndihmoi për zhvillimin e Tiranës. Qeveritë shqiptare të asokohe përshpejtuan punën për hartimin e një plani rregullues, çka përbënte risi për qytetin. Sikurse ndodh edhe sot, dilema ndërmjet “të vjetrës dhe të resë” ishte e pranishme edhe atëherë dhe shtrohej pyetja nëse duhej të ndërtohej një qytet i ri jashtë qytetit të vjetër apo duhej prekur edhe qyteti i vjetër. Sikurse ndodh gjithmonë, u arrit një kompromis.

Plani i parë rregullues i qytetit u përgatit në vitin 1923. Disa autorë mendojnë se ai u hartua nga Eshref Frashëri, ndërkohë që të tjerë mendojnë se

plani është përgatitur nga austriakët. Gjithsesi ky ishte një plan që nuk gjeti zbatim dhe u pasua disa vite më vonë, në vitet 1925-1927 nga një tjetër plan, i cili financohej nga Shoqëria italiane për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë (SVEA) me një arkitekt italian, Armando Brasini. Brasini parashikonte ndërtimin e bulevardit kryesor në aksin Veri-Jug, sheshin qendror dhe një shesh tjetër në Veri, ku parashikohej të lireshin ndërtimet e traditës. Ndërtimet e reja do të ishin të stilit klasik dhe neoklasik të fundshekullit XIX.


Ky plan nuk mund të zbatohet për shkak të kostove të larta të ndërtimeve por idetë e Brasinit do të



gjenin vend në të gjithë planet e mëvonshme rregulluese të qytetit.

Plani i tretë rregullues i kryeqytetit u hartua në vitin 1928 nga arkitekti austriak Köhler në vitin 1928. E veçanta e tij ishte se në të përfshihej gjithë qyteti.

Ndonëse ai ruajti bulevardin e propozuar nga Brasini dhe përfshiu në të dy nga ndërtesat më të rëndësishme të identitetit të qytetit Kullën e Sahatit dhe Xhaminë e Et'hem Beut, ai nuk u miratua.



Tirana midis viteve 1944-1990

Kur u çlirua, Tirana kishte 59.900 banorë, shifër që u dyfishua pas pesë vjetësh.

Për disa vite vazhdoi periudha e rindërtimit të plagëve të luftës. Duke filluar nga viti 1947 u ndërmorën reforma të thella për vendosjen e ekonomisë së centralizuar. Në vitet në vijim ekonomia u zhvillua sipas parimeve

të socializmit dhe po ashtu kultura, arsimi dhe arti. Kujdes i veçantë iu kushtua industrializimit. U ndërtuan uzina e kombinat, disa nga të cilat kishin mbi 1000 punëtorë, madje ndonjë dhe mbi 5000 punëtorë. Midis tyre ishin: Kombinati i drurit dhe Fabrika e këpucëve, Kombinati i tekstileve në lagjen e sotme Kombinat, në fillim me 5000 punëtorë e më pas me 20.000 punëtorë; Uzina e prodhimeve metalike, Fabrika e qelqit, Fabrika





e porcelanit dhe Kombinati i tullave silikate, Kombinati ushqimor, Kombinati i autotraktorëve etj.

Si pasojë e këtyre zhvillimeve, popullsia u rrit nga 108.200 banorë (1955), në 152.700 mijë banorë (1969), 189 mijë banorë (1979) dhe 238.100 mijë banorë (1989).

Tirana njohu zhvillim të madh në fushën e arsimit dhe të kulturës. U ngritën për të parën herë institute të larta arsimore: më 1946 Instituti i Lartë Pedagogjik Dyvjeçar, më 1951-1953 u themeluan gjashtë institute të larta në shkallë universitare, më 1957 u themelua prej tyre Universiteti Shtetëror i Tiranës më vonë u hapën Instituti i Lartë i Arteve (1966), Instituti i Lartë i Fizkulturës (1960), Akademia e Lartë Ushtarake (1962). U krijua dhe Instituti i Shkencave (1947), i cili më 1957 u integrua në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Më 1991 u themelua Univer-

siteti Bujqësor mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor të Tiranës të themeluar më 1951. Më vonë u organizuan institute shkencore për profile të ndryshme (industri, miniera, ndërtim, arkitekturë e urbanistikë, transport). Më 1972 u themelua Akademia e Shkencave e Shqipërisë me 13 institute shkencore në varësi të saj. Me ritme të shpejta u zhvillua jeta kulturore dhe artistike. U krijua Teatri Kombëtar Shqiptar (1947), dhe Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë. Nga një bibliotekë me 12 mijë vëllime që kishte më 1945, Tirana më 1990 u bë me 13 bibliote-





ka publike, nga të cilat vetëm Biblioteka Kombëtare me mbi një milion libra. U rrit numri i botimeve letrare, i shfaqjeve teatrore, i koncerteve, i festivaleve të këngës shqiptare, u shtua fuqia dhe programet e Radio Tiranës, filloi transmetimet Televizioni Shqiptar (1960). U shtua numri i spitaleve dhe niveli i shërbimit mjekësor u përmirësua.

Hoteli i parë shumëkatësh i ndërtuar në Shqipëri në vitet 1970 është Hotel Tirana. Ai ndodhet në pjesën veriore të sheshit Skënderbej, në ansambël me Pallatin e Madh të Kulturës dhe Muzeun Historik Kombëtar. Vendosija është bërë në bazë të një studimi pjesor urbanistik të qendrës së Tiranës. Hoteli është me 16 kate. Arkitektura e hotelit është e stilit modern e të thjeshtë, e kompozuar me forma dhe vëllime gjeometrike. Me travertinin si material i jashtëm lidhet në ngjyrë me Pallatin e Madh të Kulturës dhe Muzeun Historik Kombëtar. Ndërtimi i këtij hoteli solli risi për arkitekturën shqiptare, sepse dhe në qytetet e tjera kryesore të vendit filloi ndërtimi i hoteleve të larta në qendër, të cilat u kthyen në simbole të një arkitekture të re shqiptare.

Nga ana tjetër, sa më tepër zhvillohej baza ekonomike, aq më shumë forcohej diktatura politike dhe ideologjike e udhëheqjes së PPSH. Pushteti komunist e thelloi vazhdimisht diktaturën e brendshme dhe izolimin e Shqipërisë në marrëdhëniet me botën e jashtme.

Kjo politikë dhe gjendja e vështirë ekonomike, veçanërisht mungesat ushqimore, sollën pakënaqësinë e masave popullore, të cilat më 1990 shpërthyen në demonstrata kundër regjimit. Rasti erdhi fill pas shembjes së murit të Berlinit.



Tirana pas viteve 1990



Kështu Tirana u përfshi në periudhën e tranzicionit, të kalimit nga regjimi komunist në sistemin kapitalist. Gjatë kësaj periudhe Tirana ka pësuar dhe vazhdon të pësojë ndryshime rrënjësore. Fundi i ekonomisë së centralizuar komuniste solli mbylljen e qindra fabrikave dhe punishteve shtetërore. Në fillim të viteve 1990, nën shtytjen e papunësisë dhe të aspiratës për lëvizjen e lirë, me dhjetëra mijë të rinj mërguan jashtë vendit. Në të njëjtën kohë, me qindra mijë banorë të krahinave malore, sidomos nga pjesa verilindore e vendit u dyndën në kryeqytet dhe në rrethinat e tij. Në qytetin e Tiranës numri i të ardhurve e tejkaloi disa herë numrin e të mërguarve. Si rrjedhim i këtij procesi, brenda 10 vjetëve, popullsia e Tiranës u rrit me ritme të papara ndonjëherë, që vazhdojnë edhe sot.

Në korrik 1990 ndodhi i ashtuquajti “sulm i ambasadave”. Në dhjetor 1990 lëvizja “studentore” e përkrahur nga lëvizja punëtore, e detyroi qeverinë komuniste të lejonte pluralizmin politik, i cili i hapi rrugën procesit të përmbyesjes së shtetit komunist dhe të vendosjes së ekonomisë së tregut.

Në Tiranë u themeluan partitë e para opozitare. Në qershor 1991 Partia e Punës, e cila kishte drejtuar diktaturën, u shpërbë. U themelua Partia Socialiste e Shqipërisë. Në zgjedhjet e 31 marsit 1992 Partia Demokratike me aleatët e saj siguruan shumicën e deputetëve dhe formuan qeverinë demokratike.




Pas vitit 1990, gjatë periudhës së tranzicionit, në Tiranë ndodhën ndryshime të mëdha e të thella në të gjitha fushat, në ekonomi, kulturë, demografi, urbanistikë, në jetën politiko-shoqërore etj.

Sot, Tirana është një qytet që rritet dhe ndryshon përditë dhe është qendra e jetës politike dhe administrative e Shqipërisë ku janë vendosur pothuajse të gjitha institucionet shtetërore. Në Tiranë janë të vendosura po ashtu të gjitha përfaqësitë diplomatike të shteteve me të cilët Shqipëria ka marrëdhënie diplomatike dhe ajo gjithashtu është qendra më e madhe e edukimit në vend.

Tirana është një qytet i mbushur me hotele, restorante, bare, pub-e, qendra rinore dhe artistike, që mundësojnë një jetë aktive dhe kulturore të shumëllojshme për vendasit dhe të huajt që vizitojnë Tiranën. Gjithashtu Tirana është një qendër aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare të rëndësishme, si seminare, konferenca, festivale, spektakle etj, që e bëjnë një qytet tashmë të njohur dhe të hapur me botën.

Tirana është shndërruar në qytetin që nuk fle kurrë.



Atraksione të Tiranës brenda në qytet

Tirana ka një truall të lashtë dhe shumë të pasur me site të lashta arkeologjike, vendbanime prehistorike, qytete, fortifikime, monumente, objekte kulti dhe gjetje arkeologjike. Kjo pasuri dëshmon për lashtësinë dhe vazhdimësinë e jetës historike dhe është njëkohësisht një potencial i çmuar turistik.

KALAJA E TIRANËS

Kjo kala ndodhet në qendrën historike të qytetit të Tiranës. Ajo është një fortifikim fushor me planimetri drejtkëndore 160 x 120 m, me pjesën më të gjatë lindje – perëndim. Themelet e mureve rrethuese i takojnë ndërtimeve të kryera në kohën e Ahmet Pashë Bargjinit në gjysmën e dytë të shek. XVIII .

Në vitin 1798 kalaja ra në duart e familjes Toptani nga Kruja. Ndërsa vitin 1817 ajo përjetoi një rrethim pesë mujor nga feudalet bushatllij të Shkodrës, nga i cili pati pasoja të rënda jo vetëm për kalanë por edhe për një pjesë të madhe të qytetit. Pas bombardimit u rindërtua pjesërisht nga Toptanasit, por nuk pati jetë të gjatë sepse në vitin 1832 ajo u shemb me urdhër të Vezirit të Madh, Mehmet Reshit Pasha. Nga kalaja e vjetër, sot ruhet një pjesë e murit verior dhe trakte në anën jugore të saj. Gjatë gërmimeve të kryera në vitet 2001 dhe 2008, autorët menduan në mënyrë enthausiaste se kalaja i përket njërit prej fortifikimeve të ndërtuara ose të rindërtuara nga Perandori Justinian në shekullin e VI., por nuk kanë mundur të sjellin argumente bindëse as arkeologjike as historike në mbështetje të këtij mendimi.



MOZAIKU I TIRANËS

I zbuluar qysh në vitin 1972, gjatë punës për ndërtimin e pallateve të bllokut “Partizani”, objekti i njohur si Mozaiku i Tiranës, mbetet si një nga dëshmitë më të hereshme në truallin e qytetit. Ne fazën e parë të zbulimit dolën në dritë rrënojat e një ndërtese antike, njëri nga ambientet e të cilës ishte i shtruar me mozaik me motive të pasura gjeometrike dhe floreale. Menjëherë sipërfaqja e monumentit u rrethua dhe u vu në mbrojtje nga Instituti i Monumenteve të Kulturës. Në këtë fazë, u mendua se kemi të bëjmë me një vila rustica të shekujve II-III pas Kr. e cila transformohet në shekujt IV –VI në një ndërtim paleokristian.

Duhet të pohojmë se në këtë vend nuk janë kryer asnjëherë gërmime sistematike arkeologjike, por vetëm disa sondazhe të vogla me karakter shpëtimi në vitet 2003-2004. Megjithatë të pakta, këta gërmime e përforcuan mendimin se kemi të bëjmë vetëm me një vila rustica, e cila shtrihet në një sipërfaqe shumë më të madhe se ajo që është zbuluar. Ndërkohë nuk është gjetur asnjë e dhënë për transformimin në një ndërtim paleokristian. Disa përpjekje interpretuese mbi disa shenja në tulla apo motivet e mozaikëve mbeten ende të pamjaftueshme për të vërtetuar një transformim të tillë. Kjo situatë nuk ja ul aspak vlerat këtij objekti arkeologjik të kohës së mesme dhe të vonë perandorake romake, të pagëzuar simbolikisht



me emrin “Mozaiku i Tiranës”. Ai funksionon sot më së miri, si një nga objektet atraktive të qytetit.



URA E TABAKËVE


Është një urë guri këmbësoresh e periudhës otomane të shekullit XVIII e ngritur me kontributin e Esnafit të Tabakëve për të kaluar mbi Lanë. Në këtë periudhë Esnafi i Tabakëve kishte një pozitë të veçantë në jetën ekonomike dhe shoqërore të Tiranës.

Kjo urë dikur ishte pjesë e rrugës së Shëngjergjit që lidhte Tiranën me malësinë lindore të saj. Deri në vitet '30 ura lidhte dy brigjet e lumit Lana, ku ishin vendosur dyqanet e kasapëve dhe zejet e përpunimit të lëkurës. Ajo dëshmon për traditat e lashta të vendit tonë në fushën e ndërtimeve si dhe punën e madhe të mjeshtreve popullorë tiranas në këtë fushë.

Ura e Tabakëve dallon për arkitekturën e saj harmonike, si dhe për shpërndarjen proporcionale të elementeve të saj. Ajo ka një lartësi rreth 7 metër e gjysmë dhe përbëhet nga një hark kryesor, mbi të cilin ngrihet ura në formë kurri. Ky hark e ka hapësirën e dritës 8 metra dhe është ndërtuar me 2 rreshta harqesh

anësorë me trashësi 1 metër. Lartësia nga niveli i ujit ka qenë 3,5 metra. Kalldrëmi i urës me gjerësi 2,5 metra është i ndërtuar me gurë lumi të vendosur pa ndonjë rregull. Në të dy anët e harkut kryesor janë ndërtuar dy harqe në formë segmentesh rrethorë me hapësirë të vogël.

Në vitet 90-të të shekullit të kaluar ura u restaurua duke i rikthyer lavdinë e mëparshme. Sot ura përdoret vetëm nga këmbësorët.



KULLA E SAHATIT TË TIRANËS

Filloi të ndërtohej nga Haxhi Et'hem Beu në vitin 1822 dhe përfundoi me kontributin e familjeve të pasura të Tiranës.

Fillimisht, lartësia e kullës ka qenë 30 m dhe sahati përbëhej nga mekanizmi i kurdisjes dhe një kampanë tunxhi, numri i të rënave të së cilës tregonin orën sepse fushë dhe akrepa nuk kishte. Montimi i saj u bë nga familja Tufina, e përmendur në lidhje me orët. Në lartësi të caktuara u pajis me frëngji të vogla për ajrim, ndriçim dhe mbrojtje.

Në vitin 1928, Kulla ndryshoi formë dhe mori pamjen që ka sot. Ajo u lartësua 5 metra më shumë duke aritur në 35 m, u bë ballkoni, u montuan 4 fusha orësh me akrepa dhe u vendos një çati e tipit venecian. Në kuadrin e modernizimit të Tiranës shteti shqiptar bleu në Gjermani një orë të kohës.

Duke qenë se kulla ka shoqëruar zhvillimin e qytetit kjo u reflektua dhe në pamjen e saj ku gjysma e parë është e stilit osman, gjithë pjesa e gdhendur me gurë, kurse nga ballkoni e sipër është e stilit perëndimor.

Në vitet '30, Kulla u ndriçua për herë të parë natën. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, ajo u dëmtua, por u riparua në korrik të vitit 1946.

Deri në vitin 1970 ka qenë ndërtesa më e lartë e kryeqytetit. Pjesa e poshtme e ndërtuar me muri guri të trashë ka pasur shkallë të drunjtë që të ngjitnin në ambientet e sipërme. Gjatë ndërhyrjeve restauruese shkallët e drunjtë janë zëvendësuar me shkallë metalike.

Kulla e Sahatit është simbol i emblemës së Bashkisë së Tiranës dhe së bashku me Xhaminë e Et'hem Beut formon një ansambël arkitekturor unik.



SHTËPIA E GJETHEVE

Ndërtesa e njohur si 'Shtëpia me gjethe' (e quajtur kështu për shkak të bimës kacavjerrëse që mbulon te fasadën e saj), është kthyer tashmë në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve. I hapur më 23 Maj 2017, ai është muzeu më i ri në Shqipëri dhe një nga më të veçantët që përpiket t'u rrëfejë të rinjve dhe të huajve një nga periudhat më të errëta të historisë së vendit. Pozicionuar në qendër të Tiranës, përballë Kishës Ortodokse: "Ringjallja e Krishtit" dhe pranë Bankës Kombëtare, ndërtesa që strehoi për pak kohë Gestapon gjatë pushtimit të vendit në Luftën e Dytë Botërore, ka qenë Selia Qendrore e Përgjimeve të Shërbimit Sekret nga viti 1944 – 1991.

Ashtu si vetë historia e Shqipërisë nën diktaturën komuniste, që u instalua me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore dhe vazhdoi pothuajse një gjysmë shekulli,

edhe Shtëpia me Gjethe për një kohë të gjatë ka qenë e mbështjellë me gjithfarë legjendash dhe përbënte një të panjohur, një mister. Pëshpërimat e njerëzve dhe fëshfërimat e gjetheve... Duke hapur dyert e kësaj shtëpie, duke paraqitur veprimtaritë që janë kryer brenda saj dhe shumëçka tjetër të bashkëlidhur, ky muze do të shpalosë njëherësh pamje të shoqërisë shqiptare në kushtet e një regjimi që synonte kontrollin total mbi trupat, mendjet dhe shpirtat e njerëzve.

Shtëpia e Gjetheve është muzeu me intrigues në Shqipëri. Konsiderohet njësoj si selia e STASIT në Gjermaninë Lindore.

Gjethet kanë kuptimin e gjërave të fshehura që publiku nuk i dinte në atë regjim. Gjithë kuriozët që duan të dinë se cfarë fshihet në qendrën famëkeqe të sigurimit të shtetit, e njohur ndryshe si Shtëpia e Spiuneve, do të largohen pa fjalë. Shtëpia e gjetheve u



ndërtua në 1931 dhe fillimisht funksiononte si klinikë. Gjatë luftës së dytë botërore ajo u përdor nga Gestapo si zyre hetimi, dhe pas Luftës së dytë botërore, u përdor nga regjimi komunist i Enver Hoxhes, si seli investimi, por dhe torture për kundërshtarët e regjimit.

Brenda saj do shihni fakte dhe histori të persekutimeve të kundërshtarëve politikë, por dhe histori spinazhi, pajisje të kohës që përdoreshin për gjithë këto investigime dhe përndjekjeje të vazhdueshme ndaj njerëzve të dyshuar.



PAZARI I RI

Mori jetë në vitin 1931 dhe në vitet që pasuan njohu vetëm rritje dhe zhvillim. Ai u krijua si nevojë e shtimit të aktivitetit tregtar i cili nuk mund të përballohej vetëm me Pazarin e Vjetër.

Pas prishjes së Pazarit të Vjetër në vitin 1959, Pazarit i Ri mbeti për shumë kohë qendra e vetme, e madhe e tregtisë së mishit, peshkut, perimeve e frutave në Tiranë. Ky pazar ndodhet në atë zonë të Tiranës, që së bashku me lagjen e Mujos përfaqëson një nga zonat më të vjetra të qytetit. Edhe sot Pazarit i Ri vazhdon të mbetet një nga tregjet më të mëdhenj për tregtimin e mishit, peshkut, perimeve e frutave në kryeqytet.

Bashkia e Tiranës me mbështetjen e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve e rijetëzoi këtë zonë dhe e ktheu në një zonë të zhvillimit të biznesit për të ofruar një model të ri investimi dhe hapësire komunitare. Pazarit i Ri është një hapësirë që funksionon 24 orë, ku paradite fokusi më i madh është tek tregtimi i produkteve dhe pasdite tek çështjet e kulinarisë, për restaurantet rreth e rrotull dhe zhvillimin e aktiviteteve artistike – kulturore si festa, panairë, etj.



Turizëm rural

SHPELLA E PËLLUMBASIT NË TIRANË

Shpella e Pëllumbasit, ose Shpella e Zezë është rreth një orë ngjitje në fshatin e Pëllumbasit, 27 km në juglindje të Tiranës. Shpella ndodhet 650 metra mbi nivelin e detit dhe ka përmasa 360m gjatësi, 10-15m gjerësi dhe 15-45m lartësi të cilat nuk janë përfundimtare dhe me mjediset e mbushura me stalaktite dhe stalagmite përbën një objekt me vlera të veçanta për të studiuar evolucionin e paleo gjeografinë e gjithë zonës si dhe qarkullimin e ujërave nëntokësorë të saj. Ajo është e mbushur me mikroforma të shumta të re-

lievit nëntokësor karstik me bukuri të rrallë dhe vlera të veçanta turistike.

Është cilësuar si një nga shpellat karstike dhe vendbanimet prehistorike më të rralla të Shqipërisë (shpallur monument natyre në vitin 2002). Në këtë vend gjurmim llogaritet të kenë jetuar paraardhësit që në periudhën e hershme diku 10.000 vjet më parë. Me studimet arkeologjike është vërtetuar se në këtë kohë është përdorur teknika e krijimit të zjarrit si dhe të veglave të para primitive dhe të atyre më të zhvilluara. Skeletet e gjetura në këtë shpellë, sipas Muzeut të Shkencave të Natyrës në Universitetin e Firences, i përkasin ariut të shpellave (Ursus Speleaus), që ka jetuar 400.000 deri 10.000 vjet më parë. Në të gjithë Evropën janë vetëm pesë shpella të tilla.





UJËVARA E SHËN GJERGJIT NË TIRANË

Ujëvara e Shëngjergjit është një tjetër pasuri natyrore e Tiranës. Bukuritë që e rrethojnë për rreth dhe uji i rrjedhshëm e bëjnë këtë një vend me vlera të mëdha turistike. Ujëvara ndodhet pranë fshatit Shëgjin, të komunës Shëngjergj. Deri pranë saj, mund të shkohet me makinë dhe rruga është shumë e mirë. Kjo ujëvarë deri para gjashtë vitesh, rrinte "e fshehur" mes maleve dhe përveç banorëve të zonës, askush nuk e dinte ekzistencën e saj. Sot ajo është kthyer në një destinacion të mirëfilltë turistik me shenja orientuese.


Ujëvara furnizohet me ujë nga Mali me Gropa dhe formon një nga degët e krijimit të Lumit Erzen. Ajo ka një lartësi rreth 30 metra të dukshme dhe gjarpëron përmes hinkave në formë spirale në lartësi më të madhe dhe më pak të dukshme për syrin e vizitorit. Peisazhi është unik dhe i veçantë, ku freskia dhe bukuria e tij lidhen më së miri me njëra-tjetrën. Rruga për të shkuar në këtë mrekulli natyrore është e kalueshme dhe mund të shkoni me çfarë do lloj automjeti. Mund ta vizitoni në çdo stinë të vitit, por vera i jep akoma më shumë bukuri ku gjithçka ka çelur dhe lulëzuar. Formacioni shkëmbor rreth saj është me shkëmbinj shtresëzorë dhe me ngjyra, ku e kuqja është mbizotëruese. Në pranverë dhe në vjeshtë ajo ka një bukuri mahnitëse, nga llojshmëria e ngjyrave.

KANIONI I SHKALLËS SË TUJANIT NË TIRANË

Tirana është plot me surpriza dhe ofron shumë bukuri natyrore. Një ndër to është edhe Kanioni i Shkallës së Tujanit. Ky kanion ndodhet në afërsi të Tiranës, pikërisht në grykën midis maleve të Tujanit dhe Brrar-

it. Lumi që ka formuar këtë kanion në mijëra vjet, quhet "Lumi i Tiranës" (ose njihet si lumi i Brrarit, m.q.s. ndodhet edhe pranë fshatit Brrar) Shkalla e Tujanit është grykë e ngushtë 1000 metra e thellë, e çarë nga gëlqerorët e vargut malor Krujë-Dajt nga lumi i Tiranës. Ajo veçon malin e Dajtit nga mali i Priskës së Vogël (1241 metra). Si pasojë e disa fenomeneve dhe dukurive karstike janë krijuar dhe mjaft shpella ende të panjohura. Në të dalë të grykës, lumi i Tiranës ka formuar kanione të ngushta, mjaft të bukura për tu eksploruar. Ujërat e tij burojnë nga Mali me Gropa dhe derdhen në lumin Erzen. Kanioni ka një gjatësi prej 1.2 km dhe gjatë rrugëtimit të tij formon zgavra, katarakte të vegjël, guva etj, duke krijuar një terren

interesant për ata që preferojnë eksplorimin e tij. Kanioni ndodhet përgjatë segmentit të "rrugës së vjetër të Arbrit" e cila ndodhet në të djathtë të tij kur vjen nga Tirana. Përshkimi i rrugës së vjetër të Arbrit është një destinacion i mirë për ata që preferojnë ecjen malore. Nuk ka shenja për këtë, por me ndihmën e guidave vendase mund të gjendet lehtë. Rruga për atje nga Tirana kalon në Shtishtufinë dhe vazhdon deri në fshatin Brrar. Pjesa më e madhe është e asfaltuar dhe pastaj vazhdon në rrugë rurale të mirë. E gjithë kjo bukuri ndodhet vetëm 10 km larg qendrës së Tiranës. Pamja piktoreske dhe ajri i freskët e bejne atë një zgjedhje perfekte për të kaluar një dite ndryshe, të bukur e të qetë.





MALI ME GROPA NË TIRANË

Jo larg Tiranës gjendet një destinacion i veçantë ku mund të bëhet ecje në natyrë teksa shijohen pamje fantastike. Monumentet natyrorë të lëjnë përherë pa fjalë nga madhështia dhe kreativiteti që natyra ka treguar teksa i ka konceptuar përgjatë periudhave të ndryshme kohore. Një prej këtyre monumenteve është dhe Karsti i Malit me Gropa, që ndodhet vetëm dy orë larg me makinë nga Tirana. Gropat e shumta, prej nga rrjedh edhe emri i malit, u krijuan nga procesi i gjatë i tretjes në ujë të shkëmbinjve gëlqerorë. Këto gropa me diametër që shkon deri në dhjetra metra, krijojnë një peizazh të rrallë natyror, ku pamja që të shfaqet përpara të ngjan me një det plot me valë që ulen e ngrihen, ku në

vend të valëve janë shkëmbinj e në vend të blusë së detit mbizotëron e gjelbërta dhe grija e shkëmbinjve. Të tjerë ekspertë preferojnë t'i krahasojnë gropat me hojet e bletëve.

Mali me Gropa është një nga fenomenet e rralla të karstit në Shqipëri dhe një ndër më të rrallët dhe në Europë, për nga përmasat dhe shtrirja. Emrin ky mal e ka marrë nga sipërfaqja e sipërme e tij, që është e mbushur me gropa karstike, që janë formuar nga tretja e gurit gëlqëror në epokën e akullnajave. Këto gropa kanë një thellësi që shkon nga disa dhjetëra metra, deri në mbi 100 metra në zona të caktuara. Disa prej këtyre gropave përfundojnë me puse të cilat zgjerohen në shpella karstike të nëndheshme. Ky mal është "prodhuesi" dhe fillesa e disa përrënjevë që përshkojnë

rrethin e Tiranës. Nga ky mal furnizohet me ujë burimi i Selitës. Pika më e lartë e tij arrin në 1847.3 metra që quhet dhe maja e Mcekut (njihet dhe e Micekut). Ai është një destinacion për të gjithë të apasionuarit e ngjitjes malore dhe të skisë. Në dimer ai është pothuaj gjithnjë i mbuluar me borë, që arrin me raste deri në disa metra, duke e bërë të përshtatshëm për sportin e skisë ekstreme. Nuk ka shenja, por ka shtigje që të çojnë deri në lartësinë më të madhe. Mali është kryesisht i zhveshur nga pemët, përveç bimësisë së ulët.

Rruga për tek ai mund të vijojë në dy drejtime Tiranë -Qafëmollë dhe Tiranë - Shenmeri(Shengjergj). Rruga deri në Shenmeri dhe Qafëmollë është kryesisht e mirë. Me pas procedohet në rrugë rurale dhe ngjitja në këmbë deri në destinacion.

FSHATI PETRELË

Petrela ndodhet 12 kilometra në juglindje të kryeqytetit, së bashku me rrugën kombëtare Tiranë-Elbasan.

Petrela është një prej vendeve ku tradita është shekullore, çka e dëshmon jo vetëm kalaja, por edhe shtëpitë qindrvjecare. Zona e Petrelës karakterizohet nga natyra me një klimë tipike mesdhetare. Kjo zonë, gjithashtu për shkak të luginës së lumit Erzen dhe faktorit të klimës mesdhetare, ka një biodiversitet të pasur. Duke marrë parasysh formën e formimit fizik me fusha, kodra dhe luginë, ajo siguron një kontrast të mrekullueshëm të natyrës. Shumë restorante dhe resorte turistike janë vendosur përgjatë lumit dhe kodrat që gjenden aty pranë. Disa njerëz preferojnë që gjatë verës të bëjnë banjo dielli dhe të freskohen në ujërat e lumit Erzen, po ashtu ushtrojnë dhe aktivitetet të tjera ujore. Kalaja e Petrelës është një ndër atraksionet më të vizituara. Kalaja e Petrelës ka një histori të pasur që daton në shekullin 6, para Krishtit. Por dhe pse është ndërtuar në kohët e lashta, kjo ndërtesë sot e ka historinë në shekullin e 15. Gjatë luftërave të Skënderbeut kundër otomanëve, Kalaja e Petrelës u vu nën komandën e Mamica Kastriotit, motër të Skënderbeut. Kalaja e Petrelës (shek. IV.p.e.r)



shërben si kompleks turistik me mjedise shplothëse e shërbime. E gjithë kështjella ofron artifakte historike. Në Petrelë gjenden rrënojat e dy kishave: Qafa e Kishës dhe Kodra e Beut, si edhe disa objekte kulturi të tilla si: xhamia e fshatit, Tyrbja e Ballaban Pashës, Sofi Pashës, Baba Sakos. Karakteristikë janë edhe ndërtimet e shtëpive, kostumet popullore dhe zbukurimet e tyre. Petrela përmendet për mikroklimën e pasur, për pamje të bukura panoramike në terren kodrinor-malor. Lugina e Erzenit ofron pamje të mrekulushme, dhe mundësira për plazh.

SYRI I CIKLOPIT

Syri i Ciklopit ose siç i thonë ndryshe Gjurma e Ciklopit ndodhet rreth 4 km poshtë Krrabës, në fshatin e quajtur Skuterrë, në luginën e lumit Erzen. Ai është rreth 20 m i gjerë dhe 120 m i thellë si një perlë e fshehur në grykën e Krrabës. Syri i Ciklopit është bërë një nga destinacionet relaksuese të turizmit në Tiranë. Kjo perlë natyrore e fshehur në Krrabë tërheq çdo ditë vizitorë

dhe adhurues të aventurës që duan të eksplorojnë natyrën e egër. Kataraktet e vogla të rrethuara nga formacione shkëmbore krijojnë një panoramë që vështirë ta hasësh diku tjetër. Përveç pamjes mahnitëse, Syri i Ciklopit ofron dhe mundësinë për të bërë plazh gjatë ditëve të nxehta. Një tjetër avantazh i këtij destinacioni është afërsia me Tiranën ku mund të shkohet me mjete të lira transporti.

Çfarë thotë legjenda?

Sipas legjendës Ciklopi gjatë një përlëshje me bishëra në greminë dhe humbi syrin dhe zemrën e tij. Syri dhe zemra kanë krijuar basene me ujë të ftohtë, ku arrijnë në thellësi prej 5 metrash.

Për të shkuar te Syri i Ciklopit duhet të kalosh nëpërmjet një rruge të ngushtë, të ecësh rreth një orë nga fshati Krrabë. Mbase rruga mund të duket e vështirë, por pamja që të ofrohet ja vlenë lodhja. Udhëtimi kërkon një shpirt aventurier dhe të jesh në gjendje të ecësh në këmbë për një orë. Përveç pamjes mahnitëse, aty mund të bëni banjo dielli dhe të notoni në ujërat e kaltër në pishinat natyrore. Për të shkuar atje duhet patjetër një guidë lokale.



T U R I Z Ë M F E T A R



XHAMIA E HAXHI ET'HEM BEUT



Xhamia e Et'hem Beut është xhamia e vetme që i ka rezistuar shembjes apo dëmtimit nga periudhat e luftimeve apo edhe komunizmit në kryeqytetin shqiptar dhe është një vepër me një vlerë të çmuar. Xhamia ndodhet në sheshin Skënderbej në qendër të qytetit. Së bashku me Kullën e Sahatit dhe pallatin modern të kulturës, ajo përbën një pikë kryesore të arkitekturës së Tiranës.

Xhamia është e përbërë nga salla e zakonshme e faljes e cila është me kube (10.52 m²), një portik të hapur dhe të gjerë përballë saj, i cili ka një tavan të sheshtë prej druri dhe një çati të mbuluar me tjegulla, ndërsa në anën e djathtë një minare shumë të gjatë dhe të hollë. Xhamia nuk është punë e një periudhe të vetme ndërtimi. Pjesa më e vjetër e ndërtesës është salla me kube e faljes. Themeluesi i xhamisë, Molla Beu, ishte një feudal me origjinë nga Petrela. Ai ishte nipi i Sulejman Pashës. Ka mundësi që xhamia, e filluar në vitin 1793 gjatë sundimit të Selimit III, u la e papërfunduar për shkak të luftës që filloi në vitin 1799, midis Bushatli Ibrahimit nga Shkodra dhe Kapllan Pashë Toptanit, feudalit të Tiranës të Shqipërisë Qendrore. Molla Beu vdiq në vitin 1808. Djali i tij, Haxhi Et'hem Beu, e mbaroi xhaminë në vitin 1238 H (1822/23), siç tregohet në mbishkrimin e hajatit. Kronogramet e të dyja mbishkrimeve japin si datë të ndërtimit të saj vitin 1208 H (1793/94). Forma e kësaj pjese të ndërtesës haset shpesh në Shqipëri, me kënde të pjerrëta dhe me një tambur tetëkëndor, i cili këtu është shumë i ulët. Proporcionet e përgjithshme të xhamisë janë shumë të trasha dhe tregojnë peri-

udhën e vonë të ndërtimit. Tre dekada pas ndërtimit të kubit me kube u ndërtua një portik i jashtëm rreth dy anëve të xhamisë. Ky është një tipar i pazakontë: rrethanat e përkohshme mund t'i kenë penguar ndërtesit që ta bënin atë simetrike.

Nga brenda, salla e faljes është trajtuar në një mënyrë shumë fantastike. E gjithë sipërfaqja e mureve dhe kubeja është e mbuluar me vizatime zbukuruese të ruajtura mirë që nuk gjenden në asnjë vend tjetër. Sfondi ka një ngjyrë të ëmbël bojë hiri, përkundrajt së cilës është e vendosur në mënyrë shumë harmonizuese ngjyra e kuqe në kafe dhe një ngjyrë e gjelbër dhe shumë e ëmbël. Vizatime të ndërlikuara lulësh përzihen me piktura të qyteteve fantastike dhe të xhamive të bukura, një pamje shumë e ngjashme me ato të para në brendësitë e pasura të ndërtesave të vjetra turke. Të gjitha janë punë e grupeve shëtitëse të mjeshtrove dhe piktorëve nga fshatrat shqiptaro-valachian.

Xhamia e Haxhi Et'hem Beut u kthye në muze në vitin 1967. Pas viteve të komunizmit, kjo xhami ishte nga të vetmet në Tiranë që i rezitoi komunizmit dhe kësh-tu në 18 janar 1991, xhamia do të hapej sërish për ti shërbyer besimtarëve të qytetit të Tiranës. Pas një periudhe të gjatë, u bë tepër emergjente që të bëhej një ndërhyrje e detajuar në restaurimin e xhamisë. Kështu në shkurt të vitit 2018 xhamia do të mbyllej për t'u restauruar plotësisht deri në shtator të vitit 2021 ku përfundoi restaurimi dhe xhamia u kthye në funksionalitet të plotë.

KATEDRALJA “NGJALLJA E KRISHTIT”



Kompleksi i Katedrales së re të Tiranës “Ngjallja e Krishtit” ndodhet në zemër të kryeqytetit dhe trualli i tij u dha si këmbim i truallit të kishës së vjetër katedrale të Tiranës, shkatërruar nga regjimi ateist më 1967, mbi të cilën u ndërtua Hotel “Tirana International”.

Kompleksi i veprës u projektua nga studio “Papadatos Partnership LLP” New York dhe u realizua nga një grup arkitektësh e inxhinierësh nën kujdesin e Kryepiskopit Anastas. Kisha filloi funksionin e saj në vitin 2012, dhe u shenjtërua në vitin 2014, me pjesëmarrje të primatëve të Kishave Orthodhokse në botë. Kompleksi përbëhet nga: Kisha katedrale, Kishëza, Kambanorja, Selia e Sinodit të Shenjtë dhe Qendra Kulturore.

Katedralja “Ngjallja e Krishtit” është frymëzuar nga arkitektura e kishës së Shën Sofisë së Kostandinopojës (shek.VI). Arkitektura e katedrales ndërthur zhvillimin tradicional bizantin dhe modern, duke shpalosur dinamizmin e së vërtetës, e së

bukurës dhe të dashurisë së besimit të krishterë (Kryepiskopi Anastas).

Koncepti arkitektonik dhe vizioni i Kishës katedrale është bazuar në shenjën e kryqit (simboli qendror i jetës së krishterë) dhe në ciklin, që përmban kup-timin e kohës së përjetshme, ku aksi kulmor i të cilit lidh tokën me qiejt dhe krijon qendrën e një kryqi të madh, me gjatësi-gjerësi 49 m. Kisha mbulohet me kupolë, me diametër të brendshëm 26 m dhe lartësi 23 m, në të cilën janë 52 dritare që përfaqësojnë 52 javët e vitit kalendarik. Në kulmin e saj nga brenda mbizotëron mozaiku i madh "Krishti Pantokrator (i Gjithëpushtetshëm)", që lidh kohën e krijuar me përjetësinë.

Pranë Altarit, janë realizuar në mozaik disa skena: Hyjlindësja "Platitera (Më e gjerë se qiejt)", "Krishti i ngjallur duke porositur nxënësit", "Ngjitja në qiej e Krishtit", "Lindja e Krishtit", "Darka Mistike", "Krishti në Emaus me dy nxënësit", "Pentikostia" etj. Në sipërfaqet e mëdha të të katër shtyllave mbështetëse të kishës paraqiten 4 ngjarje kryesore nga jeta e Krishtit: Pagëzimi, Metamorfoza, Kryqëzimi, Ngjallja; dhe 4 ungjillorët: Matheu, Marku, Llukai, Joani. Ikonostasi i punuar me mermer dhe dekoruar me simbole të krishtera, paraqitet me ikona druri të pikturuara që paraqesin në radhën e parë Jisu Krishtin, Hyjlindësen Mari, Sh. Joan Pagëzorin, Ngjalljen e Krishtit dhe shenjtorë të ndryshëm, ndërsa në radhën lart paraqesin momentet kryesore nga jeta dhe vepra e Krishtit.

Pamja perëndimore nga jashtë – fasada e kishës formohet nga një hark i madh që krijon përshtypjen e mikpritjes dhe mbi hyrjen kryesore është vendosur një kryq i madh i bronzit, i qarkuar nga dy kallinj, simbol i dashurisë sakrifikuese dhe i përkushtimit (Joani 12:24).

Katedralja kremton panairin e saj ditën e Pashkës, Ngjalljes së Krishtit.

Në qoshen veriperëndimore të truallit është ndërtuar kishëza, e cila i kushtohet Lindjes së Krishtit dhe mbulohet me mbulesë në formë kryqi, dhe brenda është e zbukuruar e gjitha me ikonografi murale, nga momente nga fillimi i krijimit të botës dhe nga jeta e Krishtit, si dhe momente nga ringritja e Kishës së Shqipërisë. Kambanorja, me lartësi 46 m, konceptohet si katër llambadhe Pashke, të cilat simbolizojnë katër Ungjillorët që shpallin Ngjalljen. Ato bashkohen rreth boshtit qendror të shkallëve. Shkalla rrethore të çon në dy kate të hapura, ku janë vendosur 16 kambana. Mbi kambana, një orë katërfaqëshe shënon kohën.

Në anën lindore të Kompleksit gjendet Selia e Sinodit të Shenjtë, në të cilën janë vendosur zyrat e Sinodit, të Kryepiskopatës, biblioteka dhe dy kishëza.

Qendra Kulturore u realizua me shfrytëzimin e dy kateve të nëndheshme, nën sheshin e kishës katedrale. Qendra përmban amfiteatër, me kapacitet prej 500-850 vendesh, që përdoren për konferenca, shfaqje dhe veprimtari artistike. Në anën veriore, përpara Qendrës Kulturore, është krijuar një amfiteatër i vogël, i hapur, për veprimtari verore.

Në të djathtë të shkallëve madhështore që të çojnë drejt Kishës katedrale, gjendet Libraria. Ndërsa, në të majtë të shkallëve, ndodhen sallat për takimet e të rinjve, fëmijëve dhe e besimtarëve pas mbarimit të shërbesave kishtare.

KATEDRALJA “SHËN PALI”



Kisha Katedrale e “Shën Palit” në Tiranë është një Kishë 20-vjeçare, e stilit modern, që filloi të ndërtohet në vitin 1998, me qëllim plotësimin e nevojave të besimtarëve katolikë të kryeqytetit. Kisha e vetme famullitare katolike, që gjendej në Tiranë pikërisht aty ku sot është Hotel “Tirana International”, u shemb nga regjimi komunist. Përkushtimi i Katedrales “Shën Pali” daton më 26 janar 2002. Gjithçka u realizua falë përkushtimit dhe përpjekjeve të vazhdueshme të Arqipeshkvit të parë të Dioqezës Tiranë-Durrës, Imzot Rrok Mirdita. Projekti dhe zbatimi i punimeve u realizua nga inxhinieri Giancarlo Rigamonti dhe një kompani fiorentine, italiane, në një periudhë 4-vjeçare.

Projekti i përgjigjet formës trekëndore, ku brendashkruhet një rreth. Trekëndëshi lidhet me simbolikën e Trinisë së Shenjtë, ndërsa rrethi me nocionin e përjetësisë së një Hyji të vetëm në tre persona. Në ballë të Katedrales, sipër, shihet shtatorja e Shën Palit, të cilit i kushtohet kisha. Në oborrin përpara, qëndron statuja e Nënë Terezës së Kalkutës, shenjtëreshës shqiptare. Brenda në Katedrale, dallon veçanërisht Statuja antike e Marisë me Jezusin Fëmijë, që përcjell dukshëm shenjat

e përndjekjes komuniste dhe që i është kthyer kultit pas 70 vitesh fshehjeje dhe sekuestrimi. Në kupolën ballore, pret Krishti i Kryqëzuar. Në të majtë, pranë sakristisë, ndodhet mozaiku i Shenjtes Nënë Terezë. Statuja të tjera janë edhe ato të Shën Palit, Shna Ndout, Shën Kollit dhe busti i Shën Gjon Palit II. Në kishë, gjendet kapela e “Shën Luçisë” me statujën e shenjtës.

Kushtimi i kishës katedrale Shën Palit lidhet me shpalljen nga ai të Ungjillit në Iliri, siç shkruan vetë shenjtji, si dhe me themelimin e bashkësisë së parë të krishterë në Durrës, ku, deri në vitet '90, ishte e vendosur qendra e Dioqezës Durrës-Tiranë. Kisha katedrale ka qenë ajo e “Shën Luçisë”. Me kërkesë të Papa Gjon Palit II, u vendos që selia e dioqezës të zhvendosej në kryeqytet. Përbri Katedrales “Shën Pali”, ndodhet Arqipeshkvia e Dioqezës, selia e Arqipeshkvit metropolit, që përfaqësohet nga Imzot Arjan Dodaj, F.d.C. Arqipeshkvia disponon salla e mjedise për veprimtaritë fetare në rang dioqeze dhe më gjerë.

SELIA E SHENJTE E KRYEGJYSHATES BOTERORE BEKTASHIANE



Kryegjyshata Botërore Bektashiane si institucion i vetëm botëror në Shqipëri, përfaqëson traditën universale të bektashizmit nga shek. XIII deri më sot. Themelues është Haxhi Bektash Veliu, i cili ngriti teqenë e parë më 1282 në Kara Ujuk (Anatoli), Nevshehir sot Haxhi Hektash (muze)-Turqi. Ajo u bë qendra e përgjithshme bektashiane botërore. Bektashizmi është tarikat, udhë mistike islame, që merret me përsosmërinë shpirtërore të njeriut. Si doktrinë e praktikë fetare islame, bektashizmi i ka rrënjët në Kuran dhe në mësimet e Profetit Muhamed e të imamëve të shenjtë. Njohja nëpërmjet misionit, qëllimit të bektashizmit si burim ka doktrinën e “Katër portave” (Sheriat, Tarikat, Marifet, Hakikat). Gjatë Rilindjes Kombëtare (1860-1912) teqetë, baballarët dervishët dhanë kontribut të shquar për çështjen kombëtare me devizën “Pa atdhe nuk ka fe”. Qendra Botërore u mbyll në vitin 1925 nga qeveria turke dhe u zhvendos në Shqipëri në vitin 1930 me Kryegjysh Salih Niazi Dede. Në vitet 1930 - 1941, Kryegjyshi, Salih Niazi Dede i dha bektashizmit një dimension të ri historik. Pas tij në bazë të kodit zakonor bektashian, pasuan: Ali Riza Dede Kamber Ali Dede, Xhafer Sadik Dede, Abaz Hilmi Dede, Ahmed Myftar Dede, Haxhi Dede Reshat Bardhi, Haxhi Dede Edmond Brahimaj. Tarikati bektashian respekton të gjithë njerëzit pa dallim feje, ideje, race, ngjyre apo etnie. Brenda trevave shqiptare në Ballkan ndodhen sot tetë gjyshata: e Krujës, Elbasanit, Korçës, Skraparit, Vlorës, Gjirokastrës, Kosovës

dhe Maqedonisë së Veriut. Selia e Shenjtë mban lidhje të drejtpërdrejta me bashkësitë bektashiane, që veprojnë e jetojnë në Amerikë, Kanada, Australi, Gjermani, Hollandë, Britani e Madhe, Turqi, Egjipt, Maqedoni e Veriut, Kosovë, Mali i Zi, Bullgari, Rumani, Greqi, Hungari, Iran, Irak etj. Prej diktaturës komuniste, në vitin 1967, në Shqipërinë e izoluar, u mbyllën të gjitha teqetë bektashiane. U persekutuan dhe u burgosën klerikë dhe besimtarë. Kryegjyshi Botëror i Bektash-

injve Haxhi Dede Reshat Bardhi, mbas vitit 1990, rigjalli bektashizmin. Ai do të kujtohet për kontributin e çmuar në vitet 1967-1990, si edhe në ringritjen e besimit në periudhën e pluralizmit politik shqiptar. Në nëntor 2008 u nënshkrua marrveshja e shtetit shqiptar me Kryegjyshatën Botërore Bektashiane. Më 7 shtator 2015 u përrua Odeoni një vepër monumentale e rrallë arkitektonike, fetare, polifunkionale, me muzeun e Bektashizmit, Arkivin, Bibliotekën etj. Kryegjyshta ka dhënë e jep ndihmesë të çmuar në krijimin dhe pasurimin e tolerancës, bashkëjetesës, paqes sociale, qetësisë shpirtërore, urtësisë, harmonisë njerëzore, dialogut dhe respektimit ndërnjerëzor, kaq të nevojshëm dhe jetikë për vendin tonë dhe krejt rajonin dhe në gjithë botën.

MUZEU I QIRIAZËVE



Muzeu I Qeriazeve ndodhet pranë Universitetit Bujqësor të Kamzës, i vendosur në ambientet e Shkollës së Lart Jopublike QERIAZI. Është një muze i vogël i cili ekspozon fakte dhe dëshmi të rrugëtimit të ungjillorëve të parë siç ishte familja Qeriazi, të

cilët kanë qënë një gur themeli për Besimin Ungjillor në Shqipëri, por gjithashtu kanë qënë një mbështetje e fortë në arsimimin dhe në botimin e gjuhës Shqipe. e Në 14 nëntor 1892, Gjasim Qiriazhi me një grup atdhetarësh Ungjillorë ku ndër të tjerë vlen të përmendim edhe kontributin e atdhetarit Petro Nini Luarasin, themelojnë “Vëllazërinë UNGJILLORE”.

Synimi i tyre ishte i trefishtë : 1) përhapja e Ungjillit në Shqipëri ; 2) botimi i letërsisë shqipe ; 3) hapja dhe drejtimi i shkollave shqipe. Vlen të përmendet se Gjasim dhe Sevasti Qiriazhi hapën shkollën e

parë Shqipe të Vashave duke thyer tabun e kohës dhe përceptimin që kishte për femrat në atë kohë .Me 1908 Ungjillore morën pjesë aktivisht në organizimin dhe punimet e Kongresit të Manastirit. Në mes të persekutimeve, paragjykimeve, çkishërimeve, pengesave nga Porta e Lartë, ungjillore punuan aktivisht jo vetëm për përhapjen e mesazhit të Ungjillit por edhe për përhapjen e gjuhës, letërsisë e shkollave shqipe. Komuniteti i Krishterë Ungjillor vazhdoi të gëzonte një rritje të palëkundur dhe në vitin 1940 krenohesh me një anëtarësi prej disa qindra vetësh.




E ♦ T ♦ N ♦ O ♦ G ♦ R ♦ A ♦ F ♦ I

VESSHJE ARISTOKRACIE ÇEREKU I PARË I SHEK XX

Të gjithë familjet elitare të Tiranës i çonin fëmijët e tyre për studime jashtë shtetit që para fillimit të shekullit 19. Pjesa më e madhe e tyre kanë studiuar në Austri, Itali, Zvicër në Kembrixh dhe një pjesë tjetër në universitetet me famë të Turqisë. Kryesisht ata kanë studiuar mjeksi, financë, agronomi si dhe në Akademi Ushtarake. Në fundvitet '30 në Tiranë numëroheshin mbi 240 të rinj të diplomuar në universitetet evropiane, ky një raport shumë i konsiderueshëm në krahasim me popullatën.

VESSHJE BURRASH TE SHITRESES SE ZEJTAREVE RRETH VITIT 1920

Veshja e burrave paraqitet unitare me vecori të vogla lokale nga një zonë në tjetrën. Mbizotëronte veshja tipike e Shqipërisë së mesme me brekushe, këmishë, jelek ose mintan dhe xhokë leshi. Në këtë veshje mund të dalloheshin ndryshime që kishin të bënin me moshën dhe gjëndjen civile të bartësit por edhe me rastin për të cilin visheshin. Më tipket ishin brekushet e bardha të bëra prej një pëlhure të lehtë ku maja ishte me fije liri dhe indi me fije të hollë leshi. Ato kishin prerje të thjeshtë, nuk kishin zbukurime dhe ngjisheshin prej beli me ushkur. Pjesa tjetër që plotësonte veshjen ishin këmisha e gjatë prej pëllhure shtëpiake. Mbi këmishë vishej një mintan basme me astar për stinën e ngrohtë ose xhamadan shajaku për dimër i cili mund të ishte i bardhë, i zi ose bojë kaf. Burrat mbanin corape leshi të zeza, të bardha ose me ngjyra sipas moshës dhe opinga të bëra vetë me lëkurë lope. Në rrethin e Tiranës burrat mbanin Qeleshe të larta, më të lartat që mbaheshin në Shqipëri.





Veshje qytetare grash gjatë shek XX



115



110



100

Dy Xhybe, pjesë e veshjes qytetare të grave Shek. XX



Veshje burri me brekushe të bardha, Zall-Dajt

*Fotot me veshje janë marrë nga Volumi "Kostume popullore Shqiptare", Publikim i Institutit i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit

PËLHURË AVËLMENDI E MËNDAFSHTË, FUSHA E TIRANËS



Përparëse të pambukta ku ngjyrat ndryshojnë sipas moshës së bartëses. Fusha e Tiranës.



Këmishë grash prej pëlhere mandafshi me qenarë ngjyrash të ndryshme, të zbukurara me oja të imta të jaka e të mëngët, Fshatrat e Fushës së Tiranës



Këmishë gruaje, pjesa e sipërme prej pëlhere mëndafshi



"Kryqe" mbulesë koke e pambuktë e grave të zonës kodrinore fushore

Tre javë para se të martohej çifti bëhej muzikë e hidhej valle në shtëpitë respektive. Në qytetin e Tiranës që në vitet '20 nusja është marrë me makinë nga shtëpia e babait. Kur dilte nga pragu i hidhej oriz metaforikisht për tu shtuar dhe monedha të florinjta, për të pasur ardhmëri të mirë. Kur hynte në shtëpinë e të shoqit, pragu i derës lyhej me mjaltë që jeta çiftit të shkonte ëmbël. Në prehër i ulej një djalë i cili i hiqte corapin me idenë që nusja të sillte në jetë trashëgimtarë djem. Dasmat kryesisht bëheshin në oborret e mëdha ku ftohej e gjithë lagjia dhe miqësia. Sapetin me pajë e hapte nusja dhe kjo për të respektuar të drejtat e saj. Ditën e hënë në mëngjes të shtëpia e djalit mbërrinte një grua nga fisi i vajzës që sillte dhuratat për ta. Kjo grua quhej Xhikmjesja.


Veshjet e grave kanë kryesisht kostum me këmishë të gjatë një përparje dhe një xhokë me ose pa mëngë. Pas luftës së dytë botërore Gratë e malësisë së Tiranës filluan të veshin në përditshmëri përmbi këmishë, brekushet e leshta e të gjera. Gratë e fushës e të zonës kodrinore, filluan të futin në përdorim dimitet prej basme të pambuktë, me prerje orientale. Përmbi dimite ato vinin përparjet të punuara me avlemendin Shtëpiak nga gratë fshatare të zonës së Prezës dhe fshatrave për qark.

Që nga viti 1926 në Tiranë numëroheshin 10 kinema që përveç filmave ofronin dhe koncerte të ndryshme, ku ai më me famë është i Tefta Tashko Kocos në vitet '30. Ndërkaq që kishte dy biblioteka të mëdha, atë Kombëtare dhe Bibliotekën Carnavon që ishte biblioteka e librave të huaj, ndërtuar nga anglezët për nder të shqipdashësit Aubrey Herbert.

Tirana kishte dhe radion e saj ku trasmetoheshin kryeveprat botërore të muzikës klasike dhe asaj të lehtë. Po ashtu në Tiranë kishte shumë organe shtypi dhe shoqëri të ndryshme kulturore.

Tirana e viteve 20-30 shënoi kulmin e saj ndërsa në qytet u hapën një sërë baresh moderne si 'Kursal', 'Bella Venezia', 'Paris', 'Odeon', 'Lirija'. Në to, disa ditë të javës kishte dhe muzikë live, ndërsa këngëtarët merreshin edhe nga jashtë. Në pazarin e vjetër kishte disa restorante ose akshihone në dialekt, që shërbenin ushqim karakteristik si për shembull lokali i Ali Ballukut dhe Hamza Files. Në pazar kishte dhe mejhane që ofronin meze të ndryshme.

Ky dokument i rrallë i gjetur në arkivin e shtetit (foto poshtë) dëshmon se biznesi në Tiranë ka qenë i mirëorganizuar dhe legalisht i regjistruar në organet kompetente. Firma 'Magazina Nazionale Begeja' që merrej me tregtinë e manifakturës me shumicë e pakicë, rezultoi e regjistruar që në vitin 1900 në formë juridike kolektive dhe është më e hershmja sipas dokumentacionit.







Kostume popullore

VESHJA E GRAVE TË TIRANËS

Përgjithësisht gratë e qytetit të Tiranës dhe qytetet e tjera të Shqipërisë së Mesme në festa ceremoniale familjare përdornin veshje luksoze të qepura sipas stilit Oriental. Sic ishin Citjanet të njohura si Dimiq, Këmisha në mëndafsh natyral, Xhybet dhe Jelek të qëndisur me fije ari. Në harmoni të plotë me pjesët e tjera të veshjes ishte gjithashtu Brezi i përbërë nga pjesë metalike argjendi ose i larë në ar. Vëcanërisht spikasin qëndisjet e realizuara në mëngët e Këmishave dhe në Përparje.

VESHJA ME BREKUSHE

Si në të gjithë Shqipërinë e Mesme edhe burrat në Tiranë kanë përdorur përgjithësisht veshje me Brekushe në ngjyrë të bardhë të shoqëruar me Kemishë, Jelek në ngjyrë të kuqe të qëndisur me gajtanë në ngjyrë të zezë ose të verdhë, gjithashtu edhe Xhakëtën në copë të leshtë në ngjyrë të zezë. Më tipik kanë qenë Brekushet e bardha në copë me ngjyrë të bardhë pambuku ose me copë të leshtë fine në ngjyrë natyrale. Burrat e Tiranës mbanin një Qeleshe tepër të lartë e cila është konsideruar si një pjesë identifikuese e kësaj veshje.



VESSHJA E FSHATIT TË DARDHËS (Qyteti i Korces)

Veshja e fshatit të Dardhës (Korcë) ishte e përbërë nga copë tekstili e importuar në ngjyrë qershie të errët, i gjatë deri tek pulpa e kembës dhe tepër i gjerë në fund të saj. Sipër vishej një Cibun i përbërë nga Shajak në ngjyrë të errët (blu ose të zezë) me gajtanë në ngjyrë floriri. Pjesë e këtij kostumi ishte edhe Përparja në copë tekstili në ngjyrë të kuqe të errët, Shamia e përbërë nga mëndafsh në ngjyrë të errët. Corape të gjata të dekoruara me vija, Brezi i shoqëruar me Pafta argjendi si dhe këpucët e zeza me takë të ulët. Në këtë veshje dallohet Jaka e Këmishës e shoqëruar nga një dantellë fine.



VESSHJA E BURRAVE TË KORCËS

Përgjithësisht në fshatrat e Korcës (por sidomos në qytet gjatë shekullit të XX) në veshje përdorej Fustanella në ngjyrë të bardhë e shoqëruar me Jelek dhe Mëngore e përbërë nga Cohe të qendur me gajtane të mëndafsh të ose të florinjtë. Në Mëngore vishej gjithashtu një Cibun i përbërë nga copë e leshtë në ngjyrë të bardhë. Në kokë mbanin një Qylaf të bardhë i cili më vonë u zëvendësua nga një Festë në ngjyrë të zezë.



VESHJA ME XHUBLETË


(Zona Alpine)

Veshja me Xhubletë sipas burimeve arkeologjike është një provë e hershme e kulturës materialë të Shqipërisë. Është unike për nga stili dhe stili i saj. Pjesa më e vecantë e kësaj veshje e cila tërheq vëmendjen është Xhubleta (një lloj fundi në formë zileje). Më interesante dhe intriguese është mënyra e qepjes së Xhubletës si dhe motivet dhe ngjyrat e përdorura për dekorimin e saj dhe komponentët e tjerë si Jeleku, Brezi, Përparja dhe Corapet në formë cizmeje.



VESHJA ME TIRQ

Pjesa më e rëndësishme e kësaj veshje është Tirqi i cili ka formën e pantallonave në ngjyrë të bardhë me disa ndryshime të vogla në prerje dhe dekorim. Kjo veshje për burra është e mbrojtur në të gjitha provincat e Shqipërisë së veriut deri në qytetin e Librazhdit. Emra të ndryshëm janë përdorur për emërtimin e tyre si Tirq, Cakcire, Xhedike etj. Në përgjithësi kjo veshje ka një pamje tepër intriguese vecanërisht në ato zona që e përdornin me prerje të gjerë dhe shumë më shumë ornamente të përbëra nga gajtane me ngjyrë të zezë me material të leshtë.



VESHJA E GRAVE TË BERATIT

Veshja e grave të qytetit të Beratit ishte e pa krahasueshme me të tjerat si nga bukuria, eleganca, prerja e modelit si dhe nga motivet e përdorura për ti dekoruar ato. Materialet e përdorura për përgatitjen e tyre ishin copa Kadife Veneciane ose Franceze (në ngjyre rubini ose jeshile e errët). Kurse fibrat e përdorura për dekorimin e tyre ishin mëndafsh dhe gajtane të bera në fibra ari ose argjendi. Përgjithësisht në veshjen e grave të këtij qyteti janë ruajtur elemente të luksit Bizantin.



VESHJA E BURRAVE TË BERATIT

Veshja tipike e burrave të qytetit të Beratit ishte Fustanella e cila ishte tepër e gjerë ne prerje dhe shoqerohet me Jelek dhe Mengore i përbërë nga një pëlhurë e importuar Cohe. Burrat e besimit Kristian përdornin Cohe në ngjyrë blu të errët dhe si dekoracion përdornin kordone mëndafshi në ngjyrë të zezë dhe gajtane në ngjyrë të errët. Ata të besimit mysliman e dekoronin veten e tyre me gajtane në ngjyrë floriri.



VESHJA E GRAVE TË VLORËS

Pas gjysmës së shekullit të XIX në qytetin e Vlorës gratë vishnin fustane të gjata me pala. Sipër saj vishnin një Dolloma luksoze të qenditur me gajtane ari dhe argjendi. Pjesë e kësaj veshje ishte gjithashtu edhe Këmisha e qenditur në pjesën e Mëngëve me fije ari dhe në pjesën e fytyrës me dantellë. Pjesë e grave të qytetit në vend të fustanit vishnin Citjane të mëndafsha.

VESHJA ME FUSTANELLË

Detaji me karakteristik i kësaj veshje është Fustanel-la e cila ka paraqitjen e një fundi të gjerë të përbërë nga 100, 300, 500 kinda nga copë pambuku në ngjyrë të bardhë. Ndër të gjithë komponentet e kësaj veshje tërheq vëmendjen për nga bukuria Jelevu, Mëngoret të përbëra nga fije ari ose argjendi. Një qëndisje e tillë dallohet edhe te Brezi i lëkurës Silahu ku mbaheshin armët e brezit të cilat konsistojnë në dy Kobure, Mbatjësjet e Barutit etj të dekoruara në filigram.







Kartolina





të Tiranës





Kartolina





të Tiranës





Kartolina



të Tiranës



TIRANA

HISTORIA, TRADITA E NATYRA E KRYEQYTETIT TË SHQIPTARËVE
2023

Qendra për Administrim Social Ekonomik Territorial (**ASET**)

Adresa: Rruga "Fadil Rada" Nd.7 Hyrja 3, Tiranë



www.asetcenter.al



Qendra Aset



qendra_aset